



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202300181/7

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandim për analizimin e rastit të kontrollit të banesave të shtetasve A.Gj., L.N. dhe P.N. në fshatin Dajç të bashkisë Lezhë nga oficeri i policisë gjyqësore Zef Marku.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHMË TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Shkodër

Me shkresën nr. K2/I4-2 prot., datë 20.02.2023, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, kemi vënë në dijeni se institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me nismën e vet konform nenit 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, rastin e bërë publik në median "Vizion Plus" TV¹, në datën 03.02.2023. Ky televizion ka bërë publik rastin e kontrollit të banesës së familjes Gj. me banim në fshatin Dajç të Lezhës. Sipas shtetasës K.Gj., ajo ndodhej në banesë së bashku me dy fëmijët, ndërsa bashkëshorti kishte shkuar në Mal të Zi për të punuar. Në orët e para të mëngjesit të ditës së premte ajo ka dëgjuar një zhurmë, më tej thirrjet "Policia e Shtetit, Policia e Shtetit". Nga frika është ulur, por punonjësit e policisë tentuan të hapnin derën. Në vijim, ajo e ka hapur derën dhe tre punonjës policie kanë hyrë brenda. Njëri prej tyre e ka mbështetur atë në derë dhe dy të tjerë hynë në të dy katet e banesës. Sipas saj, ata nuk i dhanë asnjë shpjegim dhe asnjë dokument për këtë veprim. Nga këto veprime të policisë ajo dhe dy fëmijët janë terrorizuar dhe pas ndodhjes së kësaj ngjarjeje, ka njoftuar bashkëshortin e saj, shtetasin A.Gj., të cilit i ka kërkuar që të

¹ Vizion Plus TV <https://www.youtube.com/watch>

kthehej në banesë. Ai ka ardhur dhe ka deklaruar para mediave se nuk ka asnjë problem me ligjin dhe se nuk e di arsyen e ushtrimit të kontrollit të banesës së tij nga policia. Sipas medias, nga interesimi i bërë në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë është konfirmuar se para ndërhyrjes, salla operative është njoftuar nga Policia e Shkodrës për këtë aksion. Ndërsa nga një komunikim me Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, është informuar se ky aksion i policisë është mbështetur nga një grup i FNSH-së, dhe është bërë për shkak se dyshohej se në këtë banesë fshihej një person i shpallur në kërkim, i cili është i afërmi i familjes Gj.. Ndërkohë nuk konfirmohet nëse për këtë aksion ka pasur apo jo një urdhër nga prokuroria.

Në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër me shkresën nr. 1700/1 prot., datë 02.03.2023, ndërmjet të tjerave na informoi se në këtë organ është dërguar shkresa nr. 257/1 prot., datë 27.08.2022 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër e cila ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit penal nr. 511 (3279), datë 27.08.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ku është vendosur masa e sigurisë “Arrest në burg”, në mungesë, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim me inicialet A.P., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, parashikuar nga nenet 78 dhe 278/1 të Kodit Penal.

Nisur nga rrezikshmëria e lartë shoqërore që paraqeste personi i shpallur në kërkim policor dhe në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative nga specialistët për hetimin e krimit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, është bërë plani operacional nr. 38, datë 02.02.2023, për mundësimin e gjetjes dhe kapjes së këtij personi që po i fshihej drejtësisë. Sipas informacionit të përfituar, vendndodhja e mundshme e personit të shpallur në kërkim pretendohej të ishte fshati Dajç, i Lezhës, përkatësisht në njërën prej 3 hyrjeve të një ndërtese. Në këto kushte, me ndihmën e FNSH-së është bërë rrethimi paraprak i ndërtesës, me qëllim që të pengohej dalja e mundshme e personave që ndodheshin në 3 hyrjet e saj.

Punonjësit e policisë që kanë ushtruar kontrollin për gjetjen dhe kapjen e personit në kërkim kanë qenë me uniformë policore dhe janë prezantuar si punonjës policie te personat e pranishëm në banesat përkatëse duke u thënë edhe arsyet e ushtrimit të kontrollit.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar në të 3 hyrjet e ndërtesës përfshirë edhe banesën e shtetasit A.Gj. janë përpiluar procesverbalet përkatëse nga punonjësit e policisë për mosgjetjen e personit të shpallur në kërkim policor, por nënshkrimi dhe marrja e tyre është refuzuar nga personat e pranishëm.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se procesverbalet përkatëse i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër me shkresën përcjellëse nr. 1161, datë 06.02.2023.

Në vijim të ndjekjes së këtij rasti, i kërkuam Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër të na dërgonte një informacion lidhur me pyetjet si vijojnë:

1. A është bërë nga ky organ vleftësimi i kontrollit të banesës në pronësi të shtetasit A.Gj. të ushtruar nga punonjësit e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe ata të FNSH-së në datën 02.02.2023 në bazë të nenit 298/4 të Kodit të Procedurës Penale?

2. Nëse po, si ka rezultuar ai i ligjshëm apo jo?

Gjithashtu i kërkuam që bashkë me informacionin të na dërgonte edhe fotokopje të procesverbalit të kontrollit të banesës së shtetasit A.Gj..

Ky organ, me shkresën nr. 2910, datë 03.04.2023, na informoi se rasti në fjalë lidhet me procedimin penal nr. 1143 të vitit 2022, regjistruar për veprat penale të “Vrasjes me paramendim” dhe “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 78/1 dhe 278/1 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A.P.

Ndaj këtij shtetasi, i marrë i pandehur, është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është nxjerrë urdhri i ekzekutimit dhe i është dërguar për ekzekutim Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, për kërkimin dhe kapjen e të pandehurit dhe ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër në zbatim të urdhrit të prokurorit dhe të vendimit të gjykatës ku është caktuar masa e sigurimit “Arrest në burg” janë kryer verifikime, kërkime dhe kontrole në vijimësi që nga ndodhja e ngjarjes, objekt i këtij procedimi penal. Në datën 03.02.2023, pasi janë siguruar nga dy informacione policore dhe operative, janë kryer verifikime në tre ndërtesa, ku ndër të tjera edhe në banesën e shtetasit A.Gj. në fshatin Dajç, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë, veprime të cilat kanë filluar në orën 07:10.

Në lidhje me këtë verifikim dhe kërkim personi janë mbajtur procesverbalet e kërkimit të personit që nuk gjendet. Tre procesverbalet e kërkimit të personit që nuk gjendet janë dërguar në prokurori me shkresën nr. 1161 prot., datë 06.02.2023. Në këtë rast nuk është paraqitur në prokurori ndonjë procesverbal kontrolli banese, pasi objekt i veprimeve policore ka qenë vetëm kërkimi i shtetasit A.P.. Pra, në kushtet kur nuk është dorëzuar ndonjë procesverbal kontrolli banese, nuk është bërë ndonjë vleftësim kontrolli pasi nuk ka pasur akt. Por, edhe nëse do të kishte pasur ndonjë procesverbal të tillë nuk do të ishte bërë vleftësim nga prokurori për shkak të kalimit të afatit 48 orë të parashikuar në nenin 298/4 të Kodit të Procedurës Penale.

Sipas prokurorisë, nuk ka pasur kontroll banese në kuptim të nenit 298/4² të Kodit të Procedurës Penale, por policia në këtë rast ka vepruar në kushtet e nenit 298/2³ të Kodit të Procedurës Penale.

Së bashku me informacionin, organi i prokurorisë na dërgoi edhe fotokopje të praktikës së dërguar nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër me shkresën nr. 1161 prot., datë 06.02.2023, pjesë e së cilës janë kjo shkresë dhe tre procesverbalet “Për kërkimin e personit që nuk gjendet”, respektivisht shtetasit A.P., mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore Zef Marku në banesat e shtetasve A.Gj., L.N. dhe P.N..

Referuar Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr. 684, datë 25.11.2019 “Mbi rregullat për realizimin e kërkimit dhe kapjes së personave, si dhe gjetjes së sendeve në kërkim”, Kreu I, pika 10, rezulton se: *“Me kërkim kuptohet tërësia e veprimeve administrative, gjurmuese, operacionale e procedurale që kryhen nga strukturat e Policisë së Shtetit për identifikimin, lokalizimin, zbulimin, gjetjen dhe kapjen e personave në kërkim, si dhe identifikimin, bllokimin dhe sekuestrimin e sendeve të vjedhura ose të humbura.”*

Në vijim, referuar pikës 11 të këtij kreu, *“Persona në kërkim konsiderohen shtetasit shqiptarë, të huaj, ose pa shtetësi, të cilët nuk gjenden dhe kërkohen nga organet e prokurorisë, gjykatës e policisë për rastet e mëposhtme:*

- a) Kur janë të dënuar/të arrestuar dhe arratisen nga burgjet, dhomat e paraburgimit ose gjatë transportit të tyre;
- b) Kur dënohen nga gjykata me vendim të formës së prerë;
- c) Kur caktohet nga gjykata masë sigurie “Arrest në burg”;
- d) Kur prokuroria ka lëshuar urdhër ndalimi;
- e) Kur kërkohen nga Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana;
- f) Kur janë të humbur/të zhdukur që nënkuptohen personat e larguar nga vendbanimi ose vendqendrimi dhe nuk ka informacion mbi vendndodhjen e tyre ose rastet kur personat mund të kenë qenë objekt i veprimtarisë kriminale (të rrëmbyer);
- g) Kur fëmijët dhe/ose të miturit janë larguar nga kujdesi prindëror/kujdestari ligjor ose fëmijët e marrë në mënyrë të pa drejtë;

² Neni 298 “Kontrollimet”

4. Procesverbali i veprimeve të kryera i dërgohet menjëherë, por jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli, i cili brenda dyzet e tetë orëve vijuese procedon sipas nenit 301 të këtij Kodi.

²2. Kur duhet të kryhet një ndalim, të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, oficerët e policisë gjyqësore mund të bëjnë kontrollin e personit ose të lokalit, kur ekzistojnë kushtet e treguara në paragrafin 1 dhe ka arsye të veçanta urgjence që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Kur vonesa mund të dëmtojë përfundimin e suksesshëm të hetimeve, kontrolli i banesës mund të bëhet edhe jashtë kohës së parashikuar në nenin 206.

h) Kur ka dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprës penale dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes, vendi i banimit apo i punës;

i) Kur ndaj personit organet e drejtësisë kanë dhënë vendim apo urdhër për edukim të detyruar, mjekim të detyruar, izolim për shkak të sëmundjes psikike, epidemie, etj.

Po ashtu, sipas pikës 12 të po këtij Kreu, “Shumë të kërkuar” cilësohen ata persona që janë shpallur në kërkim dhe vlerësohen për rrezikshmërinë e lartë të veprës që kanë kryer ose tentojnë të kryejnë, krijojnë një impakt të madh në publik, si dhe lënia e lirë e tyre mund të jetë një rrezik i vazhdueshëm për të tretët.”

Ndërsa në nenin 298 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

1. Në rast flagrance ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të lokalit kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se mbi personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin ose që këto sende a gjurmë ndodhen në një vend të caktuar ose atje ku gjendet personi nën hetim ose i ikur.

2. Kur duhet të kryhet një ndalim, të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, oficerët e policisë gjyqësore mund të bëjnë kontrollin e personit ose të lokalit, kur ekzistojnë kushtet e treguara në paragrafin 1 dhe ka arsye të veçanta urgjence që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Kur vonesa mund të dëmtojë përfundimin e suksesshëm të hetimeve, kontrolli i banesës mund të bëhet edhe jashtë kohës së parashikuar në nenin 206.

3. Në rastet e flagrancës apo ndjekjes së personit në ikje ose kur duhet të kryhet një ndalim ose të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, policia gjyqësore merr të gjitha masat teknike, me qëllim sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave origjinale kompjuterike dhe mbrojtjen e tyre nga humbja, dëmtimi dhe tjetërsimi, si dhe kryen kontrollimet e mëtejshme të të dhënave kompjuterike, kur ka shkaqe të arsyeshme se ato përmbajnë informacion, programe apo gjurmë të veprës penale.

4. Procesverbali i veprimeve të kryera i dërgohet menjëherë, por jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli, i cili brenda dyzet e tetë orëve vijuese procedon sipas nenit 301 të këtij Kodi.

Bazuar në referencat e cituara më sipër, vlerësojmë se veprimet e kryera nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër për kërkimin dhe kapjen e shtetasit A.P., i cili është shpallur në kërkim në kuadër të procedimit penal nr. 1143 të vitit 2022, regjistruar në ngarkim të tij nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për veprat penale të “Vrasjes me paramendim” dhe “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 78/1 dhe 278/1 të Kodit Penal, janë të bazuara në aktet normative në fuqi, të arsyeshme dhe në zbatim të misionit ligjor dhe të detyrave të Policisë së Shtetit. Ndaj shtetasit A.P. nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Në zbatim të vendimit të gjykatës, nga organi i prokurorisë është nxjerrë urdhri i ekzekutimit dhe i është dërguar

për ekzekutim Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, për kërkimin dhe kapjen e të pandehurit.

Ndërkohë konstatojmë se veprimet procedurale të kryera nga punonjësit e policisë dhe respektivisht oficeri i policisë gjyqësore Zef Marku pas kryerjes së kontrollit në banesat e shtetasve A.Gj., L.N. dhe P.N., banorë të fshatit Dajç të bashkisë Lezhë, nuk janë në përputhje me pikat 2 e 4 të nenit 298 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe me nenin 117 “Ndërhyrja në mjedise” të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku parashikohet se:

“1. Mjedise, në kuptim të këtij neni, janë banesat dhe dhomat ngjitur me to, zyrat e punës, garazhet, magazinat, kapanonet, bodrumet, mjediset e veprimtarisë profesionale, tregtare, blegtorale, bujqësore, si dhe çdo pronë tjetër private që lidhet me to.

2. Ndërhyrja dhe kontrolli në mjedise mund të bëhen pa lejen e pronarit nëse:

a) është e nevojshme të parandalohet një kërcënim i çastit për jetën dhe shëndetin;

b) në çdo rast të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

3. Nëse pronari apo personi që zotëron mjedisin ose përfaqësuesi i tij nuk janë të pranishëm gjatë ndërhyrjes, sipas pikës 1, të këtij neni, duhen njoftuar menjëherë për arsyen e kontrollit për sa kohë që qëllimi i masës së marrë nuk vihet në rrezik.

4. Në të gjitha rastet e hyrjes dhe të kontrollit, sipas këtij neni, punonjësi i policisë harton një procesverbal në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, ku ndër të tjera përmenden arsyet e hyrjes, kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij. Një kopje e këtij raporti i jepet, sipas kërkesës, personit të interesuar ose personave të autorizuar prej tij”.

Veprimet e policisë, duke u futur e ushtruar kontroll në banesat e shtetasve të sipërpërmendur, janë bazuar në pikën 2 të nenit 298 të Kodit të Procedurës Penale dhe në nenin 117 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, sepse kishin si qëllim kërkimin, kapjen dhe ndalimin e personit në kërkim A.P. në zbatim të urdhrin të ekzekutimit të një vendimi arresti të dhënë nga gjykata. Ashtu sikurse shprehet edhe organi i prokurorisë, policia ka qenë në rrethana të veçanta urgjence që nuk lejonin nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Por, ndryshe nga vlerësimi i prokurorisë, ne çmojmë se në këtë rast veprimet e policisë, duke hyrë në banesat e shtetasve A.Gj., L.N. dhe P.N., për kërkimin dhe kapjen e shtetasit A.P., faktikisht përbëjnë kontroll të mirëfilltë banese për gjetjen e personit të ikur. Është mëse e qartë dhe evidente se kërkimi dhe kapja e një personi që i fshihet drejtësisë bëhet duke bërë kontrollin e mjediseve të ndryshme.

Pra, ndodhur në këtë rrethana faktike e ligjore, nga oficeri i policisë gjyqësore Zef Marku duhet të ishin mbajtur/përpiluar edhe procesverbalet e kontrollit të tre banesave të shtetasve A.Gj., L.N. dhe P.N., konform pikës 4 të nenit 117 të ligjit nr. 108/2014 dhe nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale i cili parashikon se:

“1. Policia gjyqësore dokumenton, qoftë edhe në formë të përmbledhur, të gjitha veprimet e kryera.

2. Policia gjyqësore mban procesverbal për:

- a) kallëzimet dhe ankimet e paraqitura me gojë;
 - b) të dhënat përmbledhëse dhe deklaratimet e marra nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet;
 - c) të dhënat e marra nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit;
 - ç) këqyrjet, njohjet, kontrollimet dhe sekuestrimet;
 - d) aktet për identifikimin dhe njohjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, për marrjen e plikove ose të korrespondencës dhe për vënien e sekuestros;
 - e) veprimet hetimore të deleguara nga prokurori.
3. Dokumentacioni i veprimeve të policisë gjyqësore, provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale vihen në dispozicion të prokurorit”.

Ne konstatojmë se në këtë rast nga oficeri i policisë gjyqësore Zef Marku nuk është zbatuar detyrimi ligjor për të mbajtur/hartuar procesverbalet e kontrolleve të banesave dhe dërgimin e tyre në organin e prokurorisë për të bërë vleftësimin brenda afatit ligjor prej 48 orë nga momenti i kryerjes së veprimit.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti, konstatojmë se mosveprimet e oficerit të policisë gjyqësore Zef Marku cenojnë imazhin dhe reputacionin e Policisë së Shtetit dhe për pasojë edhe të besimit publik të këtij institucioni të administratës publike. Nuk duhet të harrojmë se rritja e besimit në publik të Policisë së Shtetit është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me rritjen e performancës së këtij organi në kryerjen e misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, atë të ruajtjes së rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, gjykon se, bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, si dhe për të garantuar një sjellje profesionale e të përgjegjshme të punonjësve të policisë, domosdoshmërisht lind nevoja e një reagimi nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”, në nenin 21/c të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimeve Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”, dhe në nenin 21/d të këtij ligjit ku parashikohet se: “për shkelje të rënda, të vëna re, i propozon çdo organi, si dhe Kuvendit, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre;”,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e këtij rasti dhe të shkeljeve të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Zef Marku, efektiv i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mos zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin “Për Policinë e Shtetit” për mbajtjen/hartimin e procesverbaleve të kontrollit të banesave të shtetasve A.Gj., L.N. dhe P.N..

2. Marrjen e masave organizative për trajnimin në vijimësi të oficerëve të policisë gjyqësore lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale, për njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve gjatë kryerjes së misionit të tyre ligjor.

3. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti dhe të shkeljeve të konstatuara nga institucioni i Avokatit të Popullit në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e tyre në të ardhmen nga punonjësit e policisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi